



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORATI

Nr. 1858 Prot.

Vlorë, më 09. 2024

VENDIM

Nr. 7, datë 09.09.2024

PËR  
HAPJEN E FAQEVE/ MEDIAVE SOCIALE PËR LLOGARI TË UNIVERSITETIT  
"ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 8, pika 3, të Rregullores së UV-së, në kuadër të vizibilitetit të UV-së si dhe me qëllim promovimin dhe zhvillimin e marketingut të aktivitetit akademik, kërkimor shkencor, studetor, kulturor, si dhe shërbime të tjera të cilat ai ofron me qëllim afrimin sa më shumë të Institucionit të Arsimit të Lartë me stafin akademik studentët dhe të tretët

VENDOSI:

1. Hapjen e llogarive në emër të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në platformat Instagram, Tik Tok dhe Youtube.
2. Hapja e llogarive në emër të facebook për të gjithë njësitë kryesore dhe ku ka nevojë për njësitë bazë.
3. Specialisti (përkthyes, kurator web-i, dhe kordinuesi i aktivitet) pranë Sektorit të Komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun në bashkëpunim me Sektorin e IT, Drejtoria e komunikimit dhe Burimeve Njerëzore autorizohen të krijojnë dhe të zbatojnë llogaritë e reja të krijuara në platformat e përmendura në pikën 1 të këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Sektori Juridik për hartimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të këtyre adresave.
5. Drejtuesit e njësive bazë dhe kryesekretaret të marrin masa për drejtimin e informacioneve për veprimtaritë e njësive të tyre dhe rritjen e shikueshmërisë tek pedagogët dhe studentët.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Specialisti (përkthyes, kurator web-i, dhe kordinuesi i aktivitet), znj. Ajola Çobani.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Aurela SALIAJ

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288



Web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)